

 <small>OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TRZISTIA KOSTT sht.a TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA KOSTT d.d</small>	Referencë-Vlerësim <i>ver. 1.0</i>	FO-MP-032 <i>Page 1 from 1</i>
---	--	--

Nr. 746 Dt. 02.12.2011 **Për të gjitha palët e interesuara**
PRISHTINË-A

Lënda: Referencë për Komtel Project Engineering, implementuesin e projektit
“SCADA/EMS & Telecomm, LOT1: SCADA /EMS”

Konfirmojmë se Komtel Project Engineering nga Prishtina, në cilësi të anëtarit të kozorciumit me kompaninë franceze ALSTOM Grid (ish AREVA T&D), me sukses e ka implementuar projektin “SCADA/EMS & Telecomm, LOT1: SCADA /EMS” (Nr.ref. KCBC 312390-06133-08-026-111) në periudhën Dhjetor 2008 – Qershor 2011) dhe aktualisht po i kryen obligimet e mirëmbajtjes në afat të garancës. Ky projekt ka përfshirë:

- Dizajnin, prodhimin, furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe lëshimin në punë të RTU sistemeve të udhëheqjes dhe monitorimit për 21 trafostacione 110kV anë e mbanë Kosovës,
- Dizajnin, prodhimin, furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin dhe lëshimin në punë të dy sistemeve qendrore kombëtare të udhëheqjes dhe monitorimit (KCS dhe EKCS të SCADA / EMS) të trafostacioneve në tensionet 400, 220 dhe 110kV anë e mbanë Kosovës (serverë, stacione punuese, shtypësa, pajisje e rrjetës LAN/WAN)
- Furnizimin, instalimin, dhe lëshimin në punë të burimeve të energjisë për qendrat kombëtare të udhëheqjes dhe monitorimit (2 gjeneratorë dhe 2 mbushës të baterive 48VDC)
- Furnizimin, instalimin, dhe lëshimin në punë të sistemit qendror të HVAC (sistemit të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit) për qendrën kombëtare KCS të SCADA/EMS
- Furnizimin, instalimin, parametrizimin dhe ndërlidhjen e 5 stacioneve meteorologjike automatike në trafostacionet e qendrave rajonale të Kosovës.
- Punë instaluese elektrike dhe telekomunikuese, shtrirjen, lidhjen dhe shënimin e kabllave
- Trajnime,
- Dizajnim dhe përgatitje të dokumentacionit

Gjatë implementimit të projektit dhe gjatë afatit të disponueshmërisë së sistemit, Komteli ka ofruar përkrahje të vazhdueshme teknike. Angazhimi i stafit të Komtelit në implementimin e projektit ishte korrekt dhe profesional si dhe bashkëpunimi me stafin e KOSTT-it.

Në bazë të gjithë kësaj thënë pare, mundemi që të gjithë palëve të interesuara t’u rekomandojmë ndërmarrjen Komtel Project Engineering si punëkryes të përkushtuar punës, kualitetit dhe përmbushjes së kërkesave të klientit.

Ju lutemi që për çfarëdo informate shtesë të na drejtoheni lirisht.

Sahit Halimi, Menaxher i Projektit


në Prishtinë, Data: 02.12.2011

KOSTT

Phone: 038 501 301 130, Email: sahit.halimi@kostt.com